- Raste të ngjashme të vendeve turistike, të bazuara në Komunitet, u zhvilluan dhe organizuan në zona tjera të Pejës, Brezovicës, Fshati Zymi afér Prizrenit, Bjeshkët e Brodit në Dragash, Gryka dhe Bjeshkët e Junikut, Graçanica, zona e Mitrovicës Veriore, etj.

Eksperiencia të ngjashme të Turizmit të Komunitetit dhe aktivitete të shumta, mund të organizohen në zonat malore të banuara sezonalisht, në të gjithë Kosovën.

1.4.1.1. Projekti Trans nacional ‘Majat e Ballkanit’

Për të krijuar të ardhura për popullatën lokale, për të ndaluar braktisjen e rajoneve malore të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe për t'i sjellë këto pjesë të rajonit më afér së bashku, organizata kombëtare dhe lokale e turizmit dhe klubet e hiking-ut bashkuan forcat me Organizatën Zhvillimore Gjermane GTZ, për të zhvilluar në aspekt rajonal ‘Majat e Ballkanit’ si një destinacion për turizmin malor të aktiviteteve në natyrë. Me zhvillimin e një shtegu trans nacional për hiking, një nga të paktët në botë, u krijuua një bazë e përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm.

Projekti ndërkombëtar ‘Majat e Ballkanit’ çon përmes një prej rajoneve malore të larta dhe të egra të Ballkanit Perëndimor. Duke përdorur shtigjet e barinjve dhe shtigjet e ecjes, shtegu gjarpëron nëpër male të larta alpine deri në 2300 metra mbi nivelin e detit dhe të çon përmes peizazheve të bjeshkëve, me një larmi peizazhesh që të lënë pa frysë, duke ndryshuar nga lugina e gjelbër në liqenet malore të kristalta, ujëvarat, lumi dhe fshati i largët piktoresk i bjeshkëve, në të cilin koha duket se ka ndaluar. Gjithësesi, një "thesar i fshehur" për adhuruesit e natyrës dhe dashamirët e Hikingut. Deri njëzet vjet më parë, rajoni kishte qenë pothuajse i paarritshëm për vizitorët, gjë që e bën atë një eksperiencë dhe aventurë autentike kulturore, duke kaluar nëpër tri bjeshkët e Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

Një nga sfidat për t'u adresuar është, pse zona e bjeshkëve të Deçanit, nuk është përfshirë në shtigjet e bjeshkatarisë së "Majave të Ballkanit"? Mund të merret me mend, ndoshta mungesa e interesit dhe angazhimit të autoritetet e Deçanit, apo qëllimi i Pejës fqinje, e cila ishte e interesuar të përfshinte sa më shumë territorin e saj malor? Autoritetet e komunës së Deçanit së bashku me të gjithë aktorët e interesuar dhe Koordinatorët e Projektit, duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të përfshirë dhe zgjeruar me bjeshkët e jashtëzakonshme të Deçanit, duke marrë parasysh kapacitetet e shumta akomoduese në bjeshkë, si dhe Rrugën e re Deçan - Plavë.

1.4.1.2. ‘Via Dinarica’ në Kosovë, në Bjeshkët e Nemuna

‘Via Dinarica’ është një mega shteg ndërkombëtar për hiking, që shtrihet nga Shqipëria në Slloveni. Pjesa kryesore e shtegut pritet në mënyrë diagonale nga jug-lindja në veriperëndim, duke ndjekur natyrshëm kreshtën kryesore të ‘Alpeve Dinarike’, paralelisht me brigjet e Adriatikut.

Kohët e fundit Itinerari i Kosovës ju bashkua shtigjeve të ‘Via Dinarica’, me eksperiencia të jashtëzakonshme, duke ofruar mundësinë për të eksploruar më thellë në bukurinë e fshehur natyrore të Kosovës me hiking në Grykën e Rugovës (pjesë e Parkut Kombëtar Bjeshket e Nemuna të Kosovës) dhe mbi kreshtat e maleve, deri në kufirin e Kosovës dhe Malit të Zi.

Konkluzionet

1.5. Të menduarit për zhvillimin e produktave turistike

Ekzistenza e potencialeve dhe resurseve turistike, nuk nënkupton domosdo nivelin e zhvillimit të industrisë së turizmit ose të një destinacioni të zhvilluar turistik. Ky fakt është një nga parakushtet themelore për zhvillimin e produktit turistik dhe destinacionit turistik.

Në mënyrë që të arrihet një nivel i domosdoshëm i zhvillimit të destinacionit në një lokalitet, rajon, komunë ose vend, është e një rëndësie parësore që pushteti qendoror dhe ai lokal, të lëvizin drejt të menduarit për zhvillimin e produktit, duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë, dhe duke dhënë një shembull se si të tjerët po veprojnë në iniciativa të reja për zhvillimin e produktave.

Lidhur me zhvillimin e produktave dhe shërbimeve turistike, të hotelerisë dhe zhvillimit profesional, në përputhje me kërkesat e tregut rajonal dhe ndërkombëtar të turizmit, në nivelin e komunave të përmendura, veçanërisht në Pejë, Prizren, Graçanicë dhe Vushtrri, janë bërë disa përpjekje dhe janë realizuar disa projekte, në përputhje me mundësitet financiare, por edhe me mbështetjen e donatorëve. Por, në mungesë të politikave të favorshme të sektorit në nivelin kombëtar, edhe këto komuna kanë mbetur në gjysmë të rrugës, ku në vend të zgjidhjeve adekuate, improvizimet bëhen me sukses të kufizuar, siç është rasti me trajtimin joadekuat të sektorit të turizmit, që duhej të ishte një prioritet, për shkak të tij si vlerë e shtuar e prodhimit dhe eksportit. Kjo qasje e gabuar rezulton në humbjen e përparësive krahasuese, në raport me konkurrencën në tregun rajonal, të tilla si Maqedonia Veriore, Serbia, Greqia, madje edhe Shqipëria, ku sektori i turizmit mbështetet me të gjitha mundësitet, siç janë subvencionet, taksat e arsyeshme të TVSH-së, masat preferenciale në projektet e zgjerimit dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja, masat stimuluese për tërheqjen e vizitorëve nga tregu ndërkombëtar, etj. Në vitet e fundit, interesit i investitorëve ndërkombëtarë, veçanërisht atyre nga diaspora kosovare, është rritur për investimet e huaja direkte në sektorin e turizmit, me disa shembuj konkretë të investimeve, por politikat e pa favorshme i kanë lënë investitorët vendorë pa mbështetje, duke demotivuar investimet direkte nga burime të jashtme, në veçanti nga diaspora e Kosovës.

Problemet kryesore, të cilat demotivojnë investitorët lokalë, janë politikat bankare dhe huatë e shtrenjta, mungesa e planifikimit adekuat urban, mungesa e zonimit turistik dhe planeve rregulluese, dhe në veçanti, burokracia mjaftë demotivuese e institucioneve qendrore dhe komunale.

Me qëllim të fillimit të planifikimit, zhvillimit dhe menaxhimit adekuat të turizmit në Kosovë, posaçërisht në zonën e Deçanit, është i nevojshëm koordinimi i të gjitha entiteteve dhe aktorëve relevantë, siç janë: Ofruesit e shërbimeve turistike, shoqatat profesionale dhe shoqëria civile, komunitetet e religioze dhe të mbrojtjes së trashëgimisë, etj.

ANNEX I: Situata aktuale e pafavorshme e Bizneseve të Turizmit në Kosovë

Situata e pafavorshme e bizneseve të turizmit dhe mikpritjes Hoteliere në Kosovë

- Investime të konsiderueshme shumë të shtrenjta në infrastrukturën hoteliere dhe gastronominë,
- Mungesa ekstreme e planifikimit dhe koordinimit profesional,
- Mungesa ekstreme e menaxhimit profesional,
- Mungesë e theksuar e arsimimit dhe aftësimit profesional,
- Qasja e gabuar dhe gulfatëse e institucioneve në të gjitha nivelet,
- Politikat e pafavorshme të turizmit në të gjitha nivelet,
- Injorimi i kërkesave dhe shqetësimeve të biznesit nga institucionet,
- Mungesë e theksuar e mbështetjes me investimet në infrastrukturë,
- Ndonjëherë, orientime të gabuara dhe jo konsistente të mbështetjes së donatorëve, për shkak të koordinimit joprofesional të aktiviteteve të tyre, nga institucionet e Kosovës,
- Politika të pafavorshme dhe qasje e vështirë për hua të favorshme,
- Mungesa e investimeve të huaja, për shkak të procedurave të komplikuara, burokracisë së rëndë dhe rastet e shantazhimit të investitorëve të mundshëm dhe të interesuar.

ANNEX II: Dimensionet e Turizmit në Kosovë

Të gjitha aktivitetet turistike në Kosovë, kanë të bëjnë me një ose më shumë nga **dimensionet vijuese të turizmit**.

a. **Atraksionet:** Janë motivi kryesor për të udhëtuar. Ato mund të janë një destinacion kryesor siç është Qyteti i Vjetër i Prizrenit ose destinacion dytësor që janë vende interesante për t'u vizituar gjatë rrugës për në destinacionin kryesor, siç është Parku Kombëtar i Sharrit. Shumica e turistëve që vijnë në Kosovë nga vendet e rajonit, si Shqipëria, Serbia ose Maqedonia Perëndimore, që udhëtojnë në Kryeqytetin e Prishtinës, ose në Prizren, do të ndalojnë në Brezovicë, Luginën e Lumëbardhit ose Prevallë, për një drekë ose pushim kafeje, duke përjetuar kuzhinë tradicionale ose pamje të shkëlqyeshme. Atraksionet zakonisht përqendrohen në resurset natyrore, kulturën, etninë ose argëtimin.

- **Resurset natyrore:** Resurset natyrore janë ndërthurja e veçorive fizike (Gryka dhe Lugina e Rugovës, Bjeshkët e Deçanit, Shpella e Mermerit Gadime, Burimet e Drinit dhe Ujëvarat), klima (Qafa e Prevallës, Bjeshkët e Brodit), dhe bukuria natyrore e zonës (Parku Rajonal Gërmia, Gryka dhe Lugina e Deçanit, Bjeshkët e Vjetra të Kopaonikut). Sfida për të menaxhuar turizmin e bazuar në burimet natyrore, është ruajtja e burimeve natyrore nga ndikimi i turistëve.
- **Resurset dhe vlerat kulturore:** Kultura - një mënyrë jetese e cila vështrohet përmes fesë, historisë, qeverisë dhe traditave të një populli (Vendi Arkeologjik Ulpiana, Manastiri i Deçanit, Xhamia e Sinan Pashës, Kullat e Vjetra të Gurit të Dukagjinit).
- **Ethniciteti:** Vizitë në familje dhe miqtë (Vizita të shumta të Diasporës, në pushime dhe festa të ndryshme në Kosovë).
- **Argëtimi:** Eksperiencat turistike të gjitha madhësive në të gjithë Kosovën (Dokufest në Prizren, ‘Jeta Natës’ në Prishtinë, Festivali ‘Sunny Hill’ në Prishtinë, Festivali i Këngëve dhe Valleve Autoktone të Rugovës, Festivali i Graçanices – ‘Svetkovine i slave’, Festivali Folklorik i Deçanit).
- **Turizmi X-treme (ekstrem):** Turizmi i bazuar në aktivitete të larta adventureske (Ngjitja në Shkëmbinj, Paragliding dhe aktivitetet në natyrë “Via Ferrata” në Grykën e Rugovës, Aktivitetet Speleologjike në Bjeshkët e Pejës).

b. **Objektet për ofrimin e shërbimeve:** Shërbime të ofruara për turistët në destinacion, ose kur turistët arrijnë në atraksione.

- **Akomodimi / Strehimi:** Përfaqëson një larmi shërbimesh në hotele / motele, resorte, vendpushime malore, qendra banjeare dhe kampe.
- **Ushqim dhe Pije:** Një nga faktorët më të rëndësishëm në përvojën e përgjithshme të turizmit, ofrimi i ushqimeve tradicionale dhe ndërkontaktore dhe përvoja të vërsës / pijeve.
- **Shërbimet mbështetëse:** Zakonisht përfaqësohen nga biznese të vogla me pakicë, që ofrojnë suvenirë dhe shërbime personale. Shopingu ose Blerja është një pjesë integrale e eksperiencave të udhëtimit. Turistët kërkojnë sende unike dhe të reja, që përfaqësojnë zonën dhe kulturat që ata vizitojnë (artizanatet e argjendarisë në Prizren, Pejë / Gjakovë).
- **Infrastruktura:** Shërbimet themelore nga të cilat varet i gjithë turizmi. Këto sisteme përfshijnë sisteme uji dhe kanalizimesh, rrjetet komunikimi, pajisje mjekësore, energji elektrike, polici dhe mbrojtje nga zjarri dhe në rrugë.

c. **Transporti**

- **Shqetësimi për kohën dhe paratë:** Ky është komponenti kritik për turizmin, aftësia për të marrë turistët nga pika e tyre e nisjes në destinacion dhe mbrapa. Variabilitet e **Kohës**, sa kohë duhet për të arritur në një destinacion specifik dhe **Paraja**, sa kushton për të arritur në destinacionin tuaj. Zhvillimet e turizmit varen nga lehtësia e qasjes dhe llojet e transportit në dispozicion.

d. **Mikpritja Tradicionale**

- Mikpritja Tradicionale: Qëndrimi i komunitetit përshkon çdo vend turistik që e bën turistin të ndihet i mirëpritur dhe i sigurt. Është rezultat i ndërveprimit midis turistëve dhe popullatës lokale. Mikpritja tradicionale e Kosovës, pa marrë parasysh se cilat komunitet, është e njojur dhe një nga faktorët vendimtar dhe motivuesit e vizitave dhe qëndrimeve të paharrueshme në destinacione të ndryshme në të gjithë Kosovën.

ANNEX III: Rekomandimet për aktorët lokal

Rekomandimet

1.6. Rekomandimet për palët e interesuara lokale (qeveria, organizatat e shoqërisë civile, qytetarët e Kosovës, veçanërisht të rajonit të Deçanit mbi potencialin dhe strategjitet për zhvillimin e turizmit të butë

Rekomandime për qeverisjen lokale

- Autoritetet publike të krijojnë klimë të përshtatshme dhe kornizë adekuate për përdorimin e resurseve dhe për të krijuar nivel të favorshëm tregtar të fushës, duke ndaluar keqpërdorimin e tokës së komunës për ndërtim joadekuat nga vetë komuna,
- Përgatitja dhe angazhimi për hartimin e Planit Strategjik për Zhvillimin e Turizmit të Butë, duke përfshirë të gjithë aktorët relevant dhe pronarët e mundshëm privatë dhe investitorët,
- Të ndërmarrë hapat e duhur urgjentë, mbi veprimet e menjëherëshme kundër akteve kriminale të keqpërdorimit dhe ndërtimeve pa leje në të gjitha bjeshkët në zonën e saj, duke punuar ngushtë me të gjitha autoritetet përgjegjëse, lokale dhe në nivelin shtetëror,
- Të ndërmarrë hapat e duhur urgjentë, për veprimet e menjëherëshme kundër akteve kriminale të prerjeve të paligjshme të drunjëve dhe dëmtimeve të tjera në burimet ujore dhe biodiversitetin e përgjithshëm të zonave të tij malore,
- Studimi i Fizibilitetit mbi Zhvillimin e Produkteve të Integruese të Turizmit të Formave të Qëndrueshme të Turizmit të Butë (Aktivitetet në natyrë, ECO. Turizmi Komunitetit, Turizmi Rural dhe Agroturizëm), përfshirë të gjithë aktorët e lidhur dhe ekspertizën profesionale,
- Promovimi dhe mbështetja e partneriteteve publiko - private,

- Themelimi i Organizatës për Menaxhimin e Destinacionit DMO në nivelin e komunës, përfshirë të gjithë aktorët e lidhur dhe ekspertizën profesionale,
- Drejtoritë e komunës dhe komuniteti i biznesit, përfshirë DMO, bazuar në legjislacionin e Kosovës, të punojnë së bashku në promovimin e investimeve, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me fokus në Diasporën e Kosovës,
- Autoritetet përgjegjëse, drejtoritë përgjegjëse dhe agjencitë e Deçanit, Pejës dhe Junikut, të punojnë ngushtë me të gjithë aktorët e interesuar, për të zgjeruar dhe përfshirë shtigjet e alpinizmit në bjeskët e Deçanit dhe Junikut në hartën e projektit të "Majave të Ballkanit", duke synuar zgjerimin dhe përfshirjen në shtigjet e "Via Dinarica".
- Të mbështesë aktivitetet e biznesit të grave dhe të rindeve, posaçërisht për të mbështetur dhe punuar ngushtë me OJQ-në e grave "Jeta".

Rekomandim për organizatat e shoqërisë civile

- OJQ e Grave dhe Vajzave "Jeta", nga Deçani, duke përdorur potencialet dhe përvojën e tyre të gjatë dhe të suksesshme, dhe rrjetëzimin e saj më të gjerë, duhet përkrahur zgjerimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tyre ekzistuese, me aktivitete të turizmit të butë dhe iniciativave zhvillimore,
- OJQ-të ekzistuese dhe të reja, të punojnë ngushtë, brenda DMO, me pronarë të ligjshëm të staneve dhe shtëpive malore, në mënyrë që të promovojnë përvoja të turizmit të butë në të gjitha bjeskët e banuara, duke ofruar kapacitetet e tyre alternative të akomodimit në tregun vendor dhe ndërkombëtar të turizmit, veçanërisht Diasporën e Kosovës,
- Organizatat e shoqërisë civile, OJQ-të e fokusuara në mbrojtjen e resurseve dhe Biodiversitetit, të cilat janë shumë aktive në Deçan, kanë nevojë për më shumë mirëkuptim dhe mbështetje nga qytetarët dhe autoritetet, në mënyrë që të jenë anëtarë aktivë dhe të fortë të DMO.

Rekomandime për qytetarët e Kosovës

- Pronarët e kapaciteteve të disponueshme të akomodimit, duhet punuar më afër me DMO, agjencitë e udhëtimit dhe platformat e Rezervimit (Arnbnb, etj), duke ofruar kapacitetet e tyre si forma alternative të akomodimit, si në fshatra ashtu edhe në rajonet e banuara në stane,
- Numri më i madh i staneve ose shtëpizave malore të rindërtuara, mund të përdoren si një formë alternative e akomodimit, gjatë sezonit të bjeskatarisë, dhe si një formë e akomodimit në bazë të komunitetit, për vizitorët vendas dhe rajonalë, për Diasporën e Kosovës gjatë pushimeve verore, me shërbime gjysmë pansioni apo edhe pansion të plotë,
- Pronarët e Kullave tradicionale dhe shtëpive të vjetra, mund të ofrojnë kapacitete alternative, qoftë si akomodim B&B (fjetje me mëngjes) ose produkte dhe shërbime specifike të tyre të përshtatura, të përcjellura me rrëfime dhe legjenda,
- Kjo mënyrë unike e përvojave të turizmit të iniciuar, kërkon mbështetje në disa pikë, investime në shkallë të vogël, furnizime fillestare dhe trajnime specifike,
- Si qytetarët, ashtu edhe shoqëria civile, duhet të angazhohen me një presion më të përqendruar ndaj autoriteteve, lokale dhe në nivel kombëtar, për të ndaluar veprimet kriminale të dëmtimit dhe shkatërrimit të biodiversitetit dhe resurseve, veçanërisht në zonat malore, të tillë si ndotja dhe keqpërdorimi i burimeve të ujit dhe përrrenjtë, flora dhe resurset pyjore, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm, etj.
- Qytetarët, që jetojnë dhe qëndrojnë në Kosovë, duhet të ndryshojnë konsumin e pajustifikuar të dërgesave nga familjarët e tyre që jetojnë jashtë, duke kërkuar mbështetjen e tyre për planifikimin dhe iniciativat e tyre të orientuara për investime, në format e turizmit të butë, pra të turizmit të të qëndrueshëm,
- Qytetarët e interesuar për të investuar në forma të turizmit të butë, duhet të ndihmohen dhe mbështeten me planifikim dhe orientime lidhur me interesin e tyre, interesin e sektorit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, sikurse edhe me përkrahje nga fondet zhvillimore të Kosovës.

ANNEX IV: Kornizat e Zhvillimit të Produkteve të Kombinuara Turistike

Zhvillimi i Produktit Turistik në rajonin e Deçanit

Deçani si destinacion turistik, vlerat turistike lokale dhe rjonale

1. Qëllimi i koordinimit të gjitha fazave të zhvillimit të produktit turistik:

- Identifikimi i përcaktuesve të Produktit
- Identifikimi i Elementeve të Produktit
- Inventarizimi i Elementeve të Produktit
- Disejnimi i Produktit – Paketave turistike
 - ✓ Kombinimi i Elementeve të ndryshëm në një paketë dhe një çmim
 - ✓ Dizajni i Paketës,
 - ✓ Ofrimi dhe Promovimi i Paketave,
 - ✓ Zhvillimi i produktit turistik.

2. Qëllimi integral i angazhimit për zhvillimin e produktit

- Ndikimi dhe orientimi në mendimin më të ngritur dhe të integruar, mbi rëndësinë e zhvillimit proaktiv të produktit turistik,
- Ngritje e ndjeshme e konsideratës drejt rajonit të Bjeshkëve të Nemuna dhe Deçanit,
- Promovimi i ndërgjegjësimit për iniciativat dhe veprimet e ardhshme krijuarës dhe zhvillimore.

3. Të menduarit lidhur me zhvillimin aktual të turizmit do të thotë:

- *Qasja tradicionale për zhvillimin e turizmit*
 - ✓ Ne përcaktojmë produktin, ky është produkti ynë,
 - ✓ Tregu është në shënjestë, angazhimi i biznesit përqendrohet te kush dhe si do ta shesim produktin?
- *Qasja strategjike për zhvillimin e produktit*
 - ✓ Identifikojmë klientin tonë të targetuar
 - ✓ Sipas llojit të klientëve, ne zgjedhim llojin e produktit që na nevojitet për të

4. Turizmi në Ekonominë e Eksperiencës, një epokë e re e ekonomisë

- Në tregun ndërkontrollor të turizmit, për disa vite, u rrit kërkesa për udhëtime, të cilat:
 - ✓ Angazhojnë ndjenjat,
 - ✓ Stimulojnë mendjen,
 - ✓ Përfshinë aktivitete unike, dhe
 - ✓ Lidhen personalisht me udhëtarët, në një nivel emocional, fizik, shpirtëror ose intelektual.
- Në vend të pushimit luksoz dhe relativisht statik:
 - ✓ Interesi për eksperiencat në të gjitha fazat e udhëtimit rritet,
 - ✓ Eksperiencat bazohen në emocione të forta, përvoja, rolin aktiv dhe përfshirjen e vizitorit, gjatë gjithë udhëtimit,
 - ✓ Të gjithë ofruesit individualë të shërbimeve duhet të orkestrojnë ngjarje për t'u mbajtur mend, për klientët e tyre, në mënyrë që të angazhojnë secilin prej tyre, plotësisht personalisht, individualisht.

5. Kanalet e shpërndarjes: Praktikat aktuale dhe mundësítë potenciale

- Kanalet e Shpërndarjes në mungesë të Organizatës për Menaxhimin e Destinacionit DMO:
 - ✓ Tour Operatorët, Agjencitë Udhëtimit
 - ✓ Udhëzimet dhe materialet tjera promovuese
 - ✓ Mediat e shtypura dhe elektronike

- ✓ Panairet dhe ekspozitat për konsumatorët
- ✓ Shitjet me pakicë përmes internetit
- ✓ Organizatat e konsumatorëve

6. Elementet kryesore të Produktit Turistik

- 5 elementet thelbësorë të produktit turistik:
 - ✓ **Programi ose Atraksionet, si element kryesor dhe më i rëndësishëm** i produktit, të tilla si: atraksionet e fuqishme nga trashëgimia natyrore dhe kulturore;
 - ✓ **Elementi i dytë** i produktit për nga rëndësia, është transporti, me infrastrukturën e rrjetit dhe mjetet përkatëse;
 - ✓ **Elementi i tretë** është akomodimi dhe infrastruktura përkatëse;
 - ✓ **Elementi i katërt** është ushqimi dhe pijet, dhe
 - ✓ **Elementi i Pestë**, sipas rëndësisë, është pushimi dhe relaksimi.

7. Përbajtja e produktit turistik karakterizohet nga faktorët e mëposhtëm:

- **Faktorët vendimtar** - Motivi i udhëtimit ose Destinacioni me vlera të një rëndësie parësore, të cilat u shkaktojnë vizitorëve eksperiencat e intensitetit më të lartë;
- **Faktorët ndihmës** - rrugët e komunikimit, mjetet e transportit nga vendi i nisjes deri në destinacion, dhe
- **Faktorët shoqërues** - akomodimi, gastronomia, përbajtjet argëtuese dhe shërbime të tjera, në mënyrë që të mbështesin eksperiencat, që nga mbërritja e vizitorit në destinacion deri në largimin e tij prej andej.

8. 1. Grupet e elementeve tërheqëse

- Rekreacioni në natyrë dhe Mbrojtje Ekologjike
- Trashëgimia kulturore - ngjarje historike dhe kulturore
- Atraksione me interes të veçantë
- Turizmi në komunitet (përvoja nga mikpritja lokale dhe kuzhina tradicionale kosovare)
- Turizmi në Konferanca në sallonet e hoteleve / moteleve në Decani dhe Malet e Deçanit
 - ✓ Turizmi malor - dimëror
 - ✓ Turizmi Malor - Veror
 - ✓ Forma të tjera tërheqëse
 - ✓ Turizmi transit
 - ✓ Turizmi alpin
 - ✓ Turizmi rinor – ekskursione
 - ✓ Turizmi edukativ/arsimor.

9. SWOT ANALIZAT

10. PEST ANALIZAT

Llojet e eksperiencave të kërkua nga vizitorët

- **Arritja në Komunitet**
 - ✓ Takimi me njerëzit lokalë
 - ✓ Festat kulinare, vizita në shtëpi dhe vizita në fermë
 - ✓ Eksperiencat e komunitetit ofrojnë një mënyrë tjetër popullore për të zbuluar dhe kuptuar njerëzit dhe kulturat.
- **Aktivitete pjesëmarrëse, praktike dhe ndërvepruese**
- **Qasje speciale, prapa skenave dhe ekskluziviteti**
- **Të mësuarit dhe zbulimi**
- **Përvojat e Ndara**

- ✓ **Dinamika shoqërore e lidhur me udhëtimet**, njohjen me njerëzit, krijimin e miqësive të reja dhe forcimin e miqve të vjetër ose kalimin e kohës me familjen, është e rëndësishme. Ky studim e përforcoi këtë faktor si gjenerues të kërkësës.

Pine dhe Gilmore identifikojnë katër sfera eksperiencash:

- ✓ **Eksperiencat argëtuese** janë kryesisht pasive, por mund të janë shumë absorbuase, siç është vrojtimi se si shefi i kuzhinës copëton perimet, çan vezët, hedh brumin në ajër, pastaj provojeni;
- ✓ **Eksperiencat edukative/arsimore** janë informuese, rrisin njohuritë, aftësitë dhe angazhojnë mendjen. Ato mund të janë pasive, të tilla si leximi i paneleve interpretuese në një vend historik, ose përfshijnë pjesëmarrje aktive, të tilla si gatimi me një kuzhinier, ose të bëheni një arkeolog për një ditë;
- ✓ **Eksperiencat estetike** janë pasive, por kanë aftësinë për të zhytur plotësisht njerëzit në një përvjë. Për shembull, duke ecur në terrenet e një kështjelle, duke nuhatur lule të freskëta, duke dëgjuar një ujëvarë dhe duke ndjerë flladin; dhe
- ✓ **Eksperiencat e dyndjes** përfshijnë pjesëmarrje aktive dhe zhyt njerëzit në një aktivitet të tillë si një fundjavë në Banja ose duke vizituar shtëpi të ndryshme në një vizitë private në kopsht dhe duke takuar pronarët.

Individualisht, secila prej këtyre eksperiencave ofron një lloj vlere për blerësin. Kompanitë që integrojnë me vetëdije të katër fushat e sipërpërmendura, optimizojnë dinamikën e eksperiencës.

Perbërësit thelbësorë në Paketat e Paharrueshme të Udhëtitimit

- Bazuar në gjetjet e një studimi, ekzistojnë gjashtë përbërës thelbësorë që duhet të përfshihen në ‘recetën eksperimentale’ për sukses:
 - ✓ Ndërtoni itinerare të bazuara në tema që ju lejojnë të shtroni eksperiencat, të renditni ngjarjet, të zgjidhni furnizuesit e duhur dhe marketoni drejtë audiencave të targetuara.
 - ✓ Investoni, trajnoni dhe mbani guida të shkëlqyeshme turistike dhe drejtorë turësh. Ata janë përfaqësuesi juaj i vijës së parë dhe persona që do të shoqërohen me kompaninë tuaj.
 - ✓ Paguani ose shpërbleni në mënyrë të përshtatshme specialistët, njerëz lokal burimor ose ekspertët që japid interpretimin, tregonë historinë dhe ndajnë njohuritë, kulturën dhe pikëpamjet e tyre me turistët tuaj. Buxhetoni mjaft mirë, në mënyrë që të mbuloni shpenzimet tuaja, pasi ata të bashkohen në grup për një vakt dhe të kenë kohë për vizita të rastësishme me udhëtarët tuaj.
 - ✓ Siguroni kohën e lirë në itinerar për vetë-zbulimin dhe optimizimin e elementit të befasisë.
 - ✓ Përdorni sugjerime dhe kujtime për të krijuar një lidhje emocionale me udhëtarët tuaj.
 - ✓ Shisni ëndrrat dhe ofroni eksperiencat.

Çfarë perceptojnë vizitorët si ‘vlerë të shtuar? Për çfarë do të paguajnë një premium vizitorët?

Vizitorët paguajnë premium për perceptimin si elemente të ‘vlerës së shtuar’ të produktit	
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Sjellje ose kontakte të veçanta ✓ Shërbim i jashtëzakonshëm, i personalizuar ✓ Kontakti personal - para dhe pas ✓ Grupet e vogla ✓ Qasje speciale në objekte ✓ Vëmendje në detaje - çfarë detaje? ✓ Mundësi unike, jo zakonisht të disponueshme për udhëtarët e përgjithshëm ✓ Guida dhe shoqëruar cilësor ✓ Standard i caktuar i akomodimit 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Fleksibiliteti në itinerar ✓ Siguria, ndjenja e sigurisë ✓ Diçka e re dhe e ndryshme sa herë që udhëtojmë me ju (organizata juaj) ✓ Autenticiteti, origjinaliteti, i ruajtur në gjendjen origjinale, trashëgimia me takt ✓ Përbushja e ëndrrave ✓ Ndjenjë krenarie / reciproke ✓ Interpretim fantastik

ANNEX V: Themelimi i DMO*) në Rajonin e Deçanit

1.7. Themelimi i Organizatës për Menaxhimin e Destinacionit në rajonin e Deçanit

Duke marrë parasysh një numër të madh dhe të larmishëm të resurseve natyrore dhe kulturore, në njëren anë dhe mungesën e të gjitha llojeve të faktorëve dhe ekspertizës, për valorizimin e tyre, Deçani ka nevojë për një ndërhyrje urgjente me një master plan të menaxhimit dhe strategjinë e marketingut të destinacionit, duke krijuar një Organizatë të Menaxhimit të Destinacionit DMO. Orientuar në zhvillimin e turizmit të butë, është e nevojshme të krijohet një organ implementues, i cili do të integrojë të gjithë aktorët e interesuar, duke synuar një planifikim dhe zhvillim adekuat dhe efektiv të turizmit, përmes koordinimit të banorëve individualë të angazhuar, komunitetit të biznesit dhe organizatave, për menaxhimin adekuat të destinacionit. Shoqëria kosovare, posaçërisht autoritetet lokale, janë mjaft të politizuara, ndonjëherë duke marrë veprimet e zhvillimit, bazuar në vendime politike, pa analiza dhe planifikim paraprake, pa konsultime paraprake me ekspertë sektorialë, aktorë të tjerë, larg opinionit publik. Prandaj, është i nevojshëm themelimi i Organizatave Rajonale dhe Lokale të Menaxhimit të Destinacionit, si organe apolitike në të gjithë Kosovën, posaçërisht në zonën e Deçanit.

Organizata e Menaxhimit të Destinacionit DMO është një organ implementues për strategjinë e turizmit, duke ofruar vazhdimësi dhe integritet apolitik në procesin e zhvillimit të destinacionit, duke shërbyer interesave të gjithë zinxhirit të vlerës. DMO-të janë struktura zyrtare, që bazohen në përpjekjet e grupeve për të menaxhuar dhe tregtuar destinacionin. DMO-të zhvillojnë turizmin në mënyrë efektive, përmes ndërtimit të partneriteteve të gjera publiko - private, zhvillimit të strategjive të marketingut dhe krijimit të qendrave të informacionit për vizitorët për incoming turistët. DMO tregtojnë destinacionin dhe koordinojnë bizneset dhe organizatat individuale. DMO-të veprojnë në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal.

Një funksion kryesor i DMO është krijimi i një plani master të menaxhimit dhe strategjisë së marketingut të destinacionit. Në mënyrë tipike, DMO të nivelit lokal, operojnë zyrën e informacionit për turizmin, shpesh me një dyqan me pakicë. Disa forma të DMO-ve në nivel rajonal, janë shumë të përfshira në promovimin rajonal dhe menaxhimin e destinacionit.

DMO-të punojnë ngushtë me bizneset e turizmit dhe organizatat e interesuara në destinacion, duke përfshirë hotele, atraksione, parqe, agjenci udhëtimesh, operatorë turistikë dhe guida turistike, restorante, pika shitje me pakicë dhe vendet e konferencës.

*) Organizata e Menaxhimit të Destinacionit OMD (DMO)

Roli i Organizatës së Menaxhimit të Destinacionit DMO

DMO-të duhet të plotësojnë nevojat e destinacionit, qoftë në marketing, koordinimin e palëve të interesuara, ndikimin në klimën e biznesit, apo asistimin në zhvillimin e resurseve njerëzore. DMO duhet të ndikojë shumë në eksportin përfundimtar të destinacionit - përvojën e vizitorëve.

Karakteristikat e zakonshme të një DMO përfshijnë:

Regjistruar si një organizatë e pavarur, jofitimprurëse, një organizatë e bazuar në anëtarësim e përbërë nga një përzierje e aktorëve të turizmit: publik, privat, jofitimprurës dhe akademik nga rajoni:

- Qeveriset nga një bord drejtoresh ose komiteti ekzekutiv që reflekton anëtarësimin dhe përbërjen e destinacionit
- Një numër gjithëpërfshirës dhe i hollësishëm i rregulloreve dhe akteve nënligjore të publikuara dhe të disponueshme për çdo palë të interesuar
- Grup i larmishëm i flukseve të të ardhurave: tarifat e anëtarësimit, taksat e hoteleve, mundësitet e shitjes me pakicë, komisionet e rezervimit në internet, reklamimi në botime dhe faqe në internet
- Shërbimet kryesish falas për përdoruesit përfundimtarë.

Statistikat Turistike dhe Monitorimi

Statistikat cilësore, mundësojnë që një DMO të bëjë ndryshime strategjike në programim dhe të maksimizojë burimet. Shpesh, agjencitë qeveritare mbledhin statistikat bazë të turizmit për arritjet dhe të ardhurat si pjesë e imigracionit dhe sistemeve të mbledhjes së taksave. Një DMO mund të mbledhë të dhëna nga një larmi burimesh, për të siguruar një kuptim më të mirë të furnizimit dhe kërkesës së turizmit në destinacion dhe më gjërë.

Treguesit e industrisë

DMO-të mund të përdorin statistikat e turizmit për të inventarizuar produktet e destinacionit, për të vlerësuar kapacitetin, për të monitoruar ndryshimet dhe për të siguruar më mirë pozicionimin e tregut duke siguruar që normat dhe disponueshmëria të jenë në pajtim me konkurrencën. Mënyra më e zakonshme për të mbledhur të dhëna të industrisë është përmes një sondazhi, qoftë në internet ose personalisht.

Të dhënat duhet të mblidhen rregullisht. Shumë biznese kontribuojnë vetëm në konfidencialitetin e tyre të të dhënavë të brendshme. Çdo analizë që mbështetet në të dhënat e ofruara nga bizneset, duhet të ndahet me ata që kontribuan.

Treguesit e zakonshëm të industrisë përfshijnë:

- ✓ Objektet e akomodimit, Hotelet, Motelet...
- ✓ Dhoma të disponueshme
- ✓ Shkalla e shfrytëzimit: Numri i dhomave-netëve të rezervuara x Numri i dhomave x Numri i ditëve në një muaj x 100
- ✓ Norma Mesatare Ditore (ADR): Të ardhurat totale të fituara nga numri i dhomave të shitura atë ditë
- ✓ Të ardhurat për dhomën në dispozicion (RevPAR): Të ardhurat nga dhomat / numri i përgjithshëm i dhomave në dispozicion
- ✓ Numri i Tour operatorëve
- ✓ Udhëtimet personale: numri i ekskursioneve të realizuara x numrin e njerëzve të pranishëm
- ✓ Shkalla mesatare e ekskursionit ditor: kostoja e një ekskursioni / ditë në ekskursione.

Treguesit e Udhëtarëve

Kuptimi i profileve të vizitorëve ndihmon në identifikimin e tregjeve të synuara, krijimin e porosive domethënëse dhe zhvillimin e produkteve dhe burimeve në mënyrë të tillë që ato të plotësojnë kërkesa të veçanta. Sondazhet gjithashtu arrijnë tek udhëtarët dhe mund të jepen ndërsa vizitorët presin në radhë për një têrheqje, gjatë një transferimi nga një vend në tjetrin, ose lënë në strehim për t'u plotësuar. Disa DMO shpërblejnë ata që plotësojnë sondazhet me një shenjë të vogël vlerësimi. Një mohim i konfidencialitetit të repte gjithashtu duhet t'i jetet marrësit të sondazhit. Pyetjet e zakonshme për udhëtarin përfshijnë:

- ✓ Mosha, gjinia, raca
- ✓ Gjatësia e udhëtimit
- ✓ Pika e origjinës
- ✓ Kohëzgjatja e qëndrimit në destinacion
- ✓ Shpenzimi mesatar ditor
- ✓ Llojet e aktiviteteve të planifikuara dhe të përfunduara
- ✓ Lloji i udhëtarit (i pavatur, grupor, ture)
- ✓ Metodologjia për rezervimin e aranzhimeve të udhëtimit
- ✓ Niveli i kënaqësisë

Mbi të gjitha, treguesit duhet të respektojnë pesë elementë kryesorë të përshkruar nga UNWTO (2007):

- ✓ Relevanca për çështjen e përzgjedhur
- ✓ Mundësia e marrjes dhe analizimit të informacionit të nevojshëm
- ✓ Besueshmëria e informacionit dhe besueshmëria për përdoruesit e të dhënavë

- ✓ Qartësia dhe kuptueshmëria
- ✓ Krahasimi me kalimin e kohës dhe nëpër juridiksione dhe rajone

Avokimi për Industrinë

Si një organizatë anëtarësie, DMO komunikon rregullisht me palët e interesuara për të mësuar shqetësimet dhe idetë e tyre dhe për të arritur një konsensus të gjërë për destinacionin për çështje të spikatura. Nga ana tjetër, DMO mund të përfaqësojë interesat e palëve të interesuara tek Ministria përgjegjëse për turizmin (MTNI) dhe agjencitë tjera qeveritare kombëtare.

DMO avokon në emër të industrisë për qeveritë kombëtare dhe rajonale, investitorët, organizatat joftimprurëse, grupet e qytetarëve dhe popullatën lokale. Nga bisedat e rregullta të DMO-së ndërmjet anëtarëve të saj, çështjet kryesore mund të adresohen dhe të arrihet konsensusi që mund të ndahet me palët e prekura në destinacion. DMO gjithashtu mund të forcojë kuptimin për përpjekjet dhe sfidat përmes takimeve informuese, seminareve dhe ngjarjeve të tjera tematike, të përqendruara në menaxhimin e trashëgimisë kulturore, administrimin e mjedisit ose transportin.

Avokimi i aseteve

Industria e turizmit ka një interes të fituar për mirëqenien e mjedisit, cilësinë e jetës së njerëzve dhe ruajtjen e elementeve kulturore që krijojnë bazën për vizita. DMO punon me partnerë lokalë, siç janë organizatat joftimprurëse dhe institucionet arsimore, për të identifikuar kërcënimet dhe përmirësimet e mundshme për pasuritë e destinacionit. DMO organizon grupe pune dhe task forca për të minimizuar ndikimet në pasuritë në rrezik, të tilla si uji, mbeturinat e ngurta dhe vendet e shenja.

Mbështetja e industrisë, rritja dhe Trajnimet

DMO-të gjithashtu mund të ofrojnë trajnime për anëtarët, për të përmirësuar menaxhimin e destinacionit, praktikat e biznesit dhe bashkëveprimin me komunitetin. Programi i trajnimit do të synojë menaxherët e destinacionit dhe tregtarët, zhvilluesit e hoteleve, operatorët turistikë, pronarët e bizneseve, zyrtarët qeveritarë dhe të tjerët që merren me qëndrueshmërinë dhe konkurrencën afatgjate të destinacioneve turistike.

Angazhimi i banorëve lokal

Banorët lokal në destinacion, kanë një pjesë të madhe të rolit në industrinë e turizmit. Për të ruajtur një marrëdhënie pozitive midis industrisë së turizmit dhe banorëve lokalë, DMO mund të:

- ✓ Ftojnë banorët dhe drejtuesit e komunitetit, të marrin pjesë në këshillin ekzekutiv të DMO-së ose bordin e drejtoreve
- ✓ Pranojnë rregullisht reagimet nga banorët, në një faqe në internet ose në vende strategjike siç janë qendrat civile dhe ndërtesa qeveritare
- ✓ Mbajnë forume të rregullta për të diskutuar tema të spikatura
- Banorët lokalë që zotërojnë biznese, gjithashtu mund të:
 - ✓ Krijojnë një hapësirë brenda zyrave të DMO, për të vendosur materialet e tyre promutive
 - ✓ Reklamojnë brenda botimeve të DMO dhe në faqen e internetit
 - ✓ Zhvillojnë marrëveshje bashkëpunimi për reklamat
 - ✓ Krijojnë një program “miqësie” që lejon banorët dhe bizneset të shprehin përkushtimin e tyre për turizmin
 - ✓ Krijojnë konkurse afiniteti në internet që u kërkojnë banorëve t'u tregojnë vizitorëve për vendet në destinacion
 - ✓ Organizojnë biseda të rregullta, në lidhje me ‘zinxhirin e vlerës’ së turizmit dhe sesi bizneset lokale mund të komunikojnë dhe bashkëpunojnë më mirë, në mënyrë që të ofrojnë mallra dhe shërbime lokale për industrinë e turizmit
 - ✓ Përdorin mediat sociale për të mbledhur të dhëna dhe për të ndarë storie.

Përfitimet e Anëtarësisë

- ✓ Porosi promovuese në faqen e internetit të DMO dhe Komunës së Deçanit;
- ✓ E drejta për shpërndarjen e broshurave të objekteve të tyre turistike në qendrën e informacionit turistik
- ✓ Lidhjet e biznesit me operatorët turistikë vendas dhe ndërkombëtarë, për të promovuar aktivitetet qëndrueshme të turizmit në rajonin e Deçanit
- ✓ Qasja në hotel dhe shërbimi i rezervimit të aktiviteteve përmes qendrës së informacionit turistik dhe një sistemi të rezervimit në internet
- ✓ Dallimi i veçantë si biznes i turizmit që mbështet nismat e turizmit të qëndrueshëm në rajonin e Deçanit
- ✓ Mundësia për tu paraqitur në udhëtimet familjarizuese FAM Trips
- ✓ Qasja në gjetjet e vlefshme të hulumtimit të tregut
- ✓ Zbritje në reklamat shtesë online për udhëtarët

Përbledhje

- DMO është një organizatë e pavarur që plotëson një boshllék të rëndësishëm, duke avokuar për nevojat gjithëpërfshirëse të industrisë së turizmit si dhe banorëve vendas.
- DMO-të mund të organizohen në çdo nivel gjeografik ose politik
- DMO-të kanë një numër modelesh biznesi, por zakonisht janë jofitimprurëse, të bazuara në anëtarësim me mbështetjen e sektorit publik.
- Tradicionalisht, DMO përqendrohen kryesisht në aktivitetet e marketingut në lidhje me promovimin e të gjithë destinacionit.
- DMO-të gjithashtu mund të ofrojnë shërbime të tjera që rrisin profilin dhe konkurrencën e destinacionit, të tilla si:
 - ✓ Master Planifikimi i turizmit
 - ✓ Statistikat dhe monitorimi i turizmit
 - ✓ Avokimi i aseteve
 - ✓ Mbështetja e industrisë, rritja dhe trajnimi
 - ✓ Angazhimi i banorëve lokal.

Veprimtaritë e marketingut të DMO

Marketingu shpesh është më i suksesshmi kur është pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse. Një plan marketingu, ndihmon DMO të përcaktojë me përparsi pasuritë e një destinacioni në raport me konkurrentët, të identifikojë audiencat e preferuara dhe të zhvillojë një plan veprimi se si t'i arrijmë ato audiencia. Shumë nga këto aktivitete, mund të shtrijnë rezultatet e mëparshme të përfunduara në vizionin dhe strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të DMO.

Duhet patur kujdes, se marketingu dhe shitjet, megjithëse janë të lidhura ngushtë, janë dy aktivitete të ndryshme. Marketingu rrit ndërgjegjësimin e klientit dhe jep një mesazh; shitjet janë veprimi i drejtëpërdrejtë i ndërmarrë për të kërkuar dhe përbushur porosi të klientëve. Kështu, marketingu përfshin aktivitetet të tilla si reklamat, krijimin e broshurave dhe materialeve kolaterale, dhe marrëdhëniet me publikun; shitjet përfshijnë telemarketingun, thirrjet dhe kërkuesat me postë direkte.

Marketingu gjeneron kuptim të audiencës, i nevojshëm për të ngritur çdo lloj promovimi. Ai sqaron cilat janë trendët dhe perceptimet aktuale të udhëtimit, që vizitorët kanë për destinacionin në krahasim me vendet tjera, ndër shumë lloje të tjera të të dhënave. Komponenti kërkimor i marketingut, mbështetet në shumë burime të ndryshme, si në vazhdim:

- Hulumtim në tryezë i burimeve dytësore
- Shitjet, rezervimet dhe regjistrimet e rezervimeve

- Regjistrimet e informacionit të vizitorëve, p.sh., kartat e regjistrimit të vizitorëve, të dhënrat e formularit të rezervimit, të dhënrat e qendrës së thirrjeve ose fakes në internet
- Publikimet qeveritare
- Të dhënrat e odave dhe shoqatave të industrisë turistike
- Raportet e organizatave ndërqeveritare (UNWTO, WTTC)
- Analiza tregtare nga botimet e porositura ose të disponueshme
- Regjistrim ose prerje e të dhënave nga aktivitetet e konkurrencës primare
- Hulumtime cilësore ose nga kërkimet
- Diskutimet në fokus grupe për të identifikuar perceptimet
- Pjesëmarrja në shfaqjet tregtare
- Vëzhgimi i sjelljes së vizitorëve në ose përreth një vendi turistik
- Trendët në mjedisin e jashtëm të funksionimit të udhëtarëve
- Kërkime sasiore
- Hulumtime të modelit të sjelljes së udhëtarëve
- Sondazhe të perceptimeve të vizitorëve
- Sondazhet e kënaqësisë së klientit
- Sondazhet e industrisë për perceptimet dhe sfidat.

ANNEX VI: Definimi dhe organizimi i Zonave të Mbrojtura Turistike

1.8. Rekomandim - përcaktimi dhe organizimi i zonave të mbrojtura turistike

Një zonë turistike është një zonë e përbërë nga hapësirat turistike, që janë të lidhura ngushtë për nga natyra, historia dhe kultura ose në ndonjë mënyrë tjeter. Një zonë turistike është krijuar për të mundësuar udhëtime me qëndrim më të gjatë se 2 netë dhe 3 ditë, përmes bashkëpunimit midis vendeve të saj turistike, me qëllimin më të madh për të rritur atraktivitetin e këtyre vendeve.

Përcaktimi i Zonave të Mbrojtura Turistike në Deçan*

Mbrojtja e Zonave turistike, të përcaktuara në mënyrë specifike në zonën e Deçanit, është një proces i domosdoshëm, që duhej të kishte ndodhur dekada më parë. Është fakt, që rajoni Deçanit, ka resurse natyrore shumë të pasura dhe të larmishme, të cilat deri më tanë, për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe mosrespektimit të ligjit, po pësojnë dëme të shumta deri në degradimin e mjedisit dhe biodiversitetit të tij.

Në mënyrë që të ndalohen dëmtimet dhe degradimi i resurseve natyrore dhe kulturore, të dy autoritetet kombëtare dhe lokale duhet të ndërmarrin hapa urgjentë për:

- Identifikimi i Zonave Turistike dhe Lokaliteteve turistike,
- Përkufizimi i Zonave dhe Lokaliteteve Turistike të Deçanit, në përputhje me Planin Hapësinor dhe Strategjinë e Parkut Kombëtar Bjeshket e Nemuna,
- Përfshirja e të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit në diskutimin publik para-aprovimit,
- Miratimi në Komunë, me pëlgimin e autoriteteve kombëtare, i Zonave dhe Lokaliteteve turistike,
- Të punohet në studimin e Fizibilitetit, në lidhje me kornizën e projekteve të mundshme të zhvillimit të turizmit,
- Puna në planifikimin urbanë dhe të detajuar të zonave turistike, në përputhje me Planin Hapësinor të Bjeshkëve të Nemuna
- Promovimi i Zonave dhe lokaliteteve turistike, me plane urbanistike dhe të hollësishme, si dhe Propozimi i Projekteve të Zhvillimit të Turizmit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

*) Qasja bazohet në projektin "Zhvillimi i Produkteve të Rajonit Bjeshket e Nemuna" në 2007, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Grupi i Ekspertëve të Turizmit, i përbërë nga ekipi ndërministror, OJQ-të e lidhura me turizmin dhe drejtori të bashkive, të mbështetur nga GTZ gjermane. Materialet e shkruara të këtij projekti shumë të mirë, mund të shërbejnë si bazë për procesin e ri të propozuar të Zonimit të Turizmit në zonën e Deçanit.

Propozimi për identifikimin e Zonave të Mbrojtura të Turizmit dhe Lokaliteteve të Deçanit

1. Zona Turistike e Deçanit me rrithinë:

- Lokaliteti i Luginës së Lumëbardhit,
- Lokaliteti i Liqenit Radoniqi,
- Lokaliteti Podi Geshtenjave (Plaja e Gështenjës)

2. Zona Turistike e Deçanit dhe Bjeshkëve të saj:

- Lokaliteti i Pishave të Deçanit,
- Lokaliteti i Bellesë dhe Pleqes,
- Lokaliteti i Kozhnjerit,
- Lokaliteti i Luginës së Lumëbardhit,
- Lokaliteti Bjeshket (Bjeshkët e Belegut, Prelepit, Roshkodolit, Milishevci, Zllonopoja, Baballoqit,
- Lokaliteti Bjeshkët Zallit i Rupës, Carrabregu, Deçanit, Pllacica e Vokshit, Stanishta e Zogut, Qershizat, Kurvalla.

3. Zona Turistike e Bjeshkës së Strelcit

- Lokaliteti i Bjeshkës së Strelcit

Propozimi i projekteve të nevojshme në lidhje me Zonat dhe Lokalitetet e Mbrojtura Turistike të rajonit të Deçanit

Projektet e propozuara në nivelin komunal të Deçanit:

1. Hartimi i planeve urbanistike dhe të detajuara të lokaliteteve turistike:

- Lokaliteti turistik Lugina e Lumëbardhit,
- Lokaliteti turistik Radoniqi,
- Lokaliteti turistik Podi Geshtenjave
- Lokaliteti turistik Pishat e Deçanit,
- Lokaliteti turistik në Bellea dhe Pleqa,
- Lokaliteti turistik në Kozhnjer,
- Lokaliteti turistik në Luginën e Lumëbardhit,
- Lokalitetet turistike (Bjeshka e Belegut, Prelepit, Roshkodolit, Milishevci, Zllonopoja, Baballoqit).
- Lokaliteti turistik (Bjeshka: Zalli i Rupës, Carrabregu, Decani, Pllacica e Vokshit, Stanishta e Zogut, Qershizat, Junik, Dobroshit, Kurvalla).
- Lokaliteti turistik i Bjeshkës së Strelcit.

1. Shtrirja organizative dhe institucionale e sektorit të turizmit;

2. Përfundimi i infrastrukturës ligjore të turizmit, në kompetencën e qeverisjes vendore;

3. Mundësítë dhe sfidat e Zhvillimit të Turizmit të Butë në zonën e Deçanit

4. Stimulimi i zhvillimit, mbrojtjes së artit tradicional dhe veprimtarive artizanale;

5. Mbështetje në kultivimin e gastronomisë tradicionale;

6. Mbështetje për zhvillimin e promovimit dhe marketingut të turizmit në nivelin komunal;

7. Identifikimi dhe promovimi i ditëve të shënuara, manifestimeve në nivelin komunal;

8. Zhvillimi i projektit të sinjalizimit turistik;
9. Mbështetja e zhvillimit të resurseve njerëzore në sektorin e turizmit;
10. Aktivitete promovuese në nivelin komunal;
11. Krijimi i politikave të favorshme për investime në turizëm.

ANNEX VII: Kornizë Plani për Trajnimin e Komunitetit Lokal për mundësitetë e turizmit

1.9. Propozimi i një Plani Kornizë për Trajnimin e Komunitetit Lokal mbi mundësitetë e turizmit

Trajnimi i Komunitetit Lokal mbi mundësitetë e turizmit	
2 ditë Programi i Trajnimit Informativ	
➤ Mundësitetë dhe parakushtet e zhvillimit të turizmit të komunitetit në Kosovë dhe Deçan	
➤ Cilat forma të Aktiviteteve të Turizmit të Komunitetit në Deçan	
➤ Informacionet themelore mbi destinacionin e mundshëm - Deçani dhe rajoni më i gjërë	
➤ Roli dhe ndikimi ndërveprues i turistëve brenda komunitetit lokal të Deçanit	
3 ditë Instrukcionet bazë të praktikës profesionale	
➤ Informacion mbi ofrimin e shërbimeve të pritjes dhe akomodimit	
✓ Prezantim praktik brenda Kullave B @ B, Akomodim shtepiak dhe në Hotel	
➤ Informacioni mbi përgatitjen e produkteve ushqimore dhe pijeve, menu-së dhe diversifikimin e ushqimit,	
✓ Prezantim praktik brenda Kullave B @ B, Akomodim shtepiak dhe në Hotel	
➤ Informacioni bazë për sigurimin e produkteve dhe shërbimeve I	
✓ Udhëzime themelore për sigurimin e shërbimeve; mëngjes, drekë, darkë, lunch paket, piknik,	
✓ Prezantim praktik brenda Kullave B @ B, Akomodim shtepiak dhe në Hotel	
➤ Informacion bazë për sigurimin e produkteve dhe shërbimeve II	
✓ Udhëzime bazë mbi format tradicionale të ofrimit të Shërbimit: mëngjes, drekë, darkë, pako dreke, piknik,; shoqërim në pirjen e kafës dhe çajit	
✓ Prezantim praktik brenda Kullave B @ B, Akomodim shtepiak dhe në Hotel	
➤ Rezume e përbashkët – Brainstorming - Stuhi mendimesh për mësimet e mësuara.	

ANNEX VII: Rekomandimi i politikave dhe strategjive të nevojshme për t'u zbatuar nga institucionet

1.10. Identifikimi i pengesave që mund të jenë të pranishme për zhvillimin e turizmit të butë në Kosovë dhe në rajonin e Deçanit

Mirëkuptimi, vlerësimi adekuat dhe shpërblimi i sektorit të turizmit në Kosovë
• Të ndryshojë perceptimi i gabuar dhe të kuptohet rëndësia e Industrisë së Turizmit dhe Mikpritjes,
• Të mësohet më shumë dhe të ofrohet vullnet më konstruktiv politik, për të njojur dhe pranuar rolin e Zhvillimit të Turizmit në Zhvillimin Ekonomik dhe të Përgjithshëm të Kosovës,
• Të intensifikohen përgatitjet dhe të finalizohet Hartimi i Ligjit të ri të përmirësuar për Turizmin dhe Mikpritjen, duke përfshirë ekspertë me përvojë vendas dhe ndërkombëtarë, duke synuar fazën e hershme përfundimtare
• Të intensifikohen përgatitjet dhe përfundimisht të finalizohet Strategjia për Turizmin dhe Mikpritjen Hoteliere, duke përfshirë ekspertë me përvojë vendas dhe ndërkombëtarë, duke synuar fazën e hershme përfundimtare

- Përcaktimi dhe avancimi i pozicionit të Industrisë së Turizmit dhe Mikpritjes Hoteliere, brenda prioriteteve, së bashku me sektorët e tjera;
- Të njihen dhe vlerësohen si duhet ndikimet ekonomike të sektorit të Turizmit dhe Mikpritjes Hoteliere
- Të njihen, vlerësohen si duhet dhe rregullohen statistikat e turizmit, në përputhje me Rregulloret e UNWTO dhe praktikat e BE,
- Të regjistrohen dhe përcjellën me përpikëri Shpenzimet Turistike dhe të Ardhurat, përfshirë këtu edhe nga turistët e Diasporës,
- Të mirëkuptohen, pranohen, dhe rregullohen të Ardhurat turistike nga turistët ndërkombetarë, përfshirë Diasporën, si 'Eksport i Brendshëm', dhe të zbatohen përfitimet ligjore, si në sektorët e tjera, për të gjithë përfituesit e biznesit, të cilët mirëpresin dhe u shërbejnë turistëve ndërkombetarë në Kosovë, duke kontribuar në bilancin tregtar të Kosovës,
- Të kontribuohet në përmirësimin e situatës ekonomike të bizneseve të turizmit, duke promovuar zhvillimin më efektiv të sektorit, tërheqjen e investimeve të huaja direkte, me politika tatimore më pozitive, duke e zbritur TVSH-në - Tatimet mbi Vlerën e Shtuar, në mesataren prej 6-8% (6% për akomodimin, agencitë e udhëtimit Incoming (hyrës) dhe operatorët turistikë, si dhe të ardhurat nga ushqimi dhe shitja e pijeve vendore; 8% në të ardhurat e agjencive të udhëtimit jashtë dhe operatorëve turistikë, si dhe të ardhurat nga shitja e pijeve alkoolike të importuara),
